

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6955
E premte, 28 korrik 2023
Çmimi 0.40 €

Murtaja afrikane e dërrit përhapet në Dragash

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇIFTET E REJA NË PRITJE TË BANESAVE TË PREMTUARA NGA KURTI

FAQE 4-5



Qeveria aktuale e Kosovës, e cila është zgjedhur në mars të vitit 2021, ka premtuar ndërtimin e 4 000 njësive banesore për çiftet e reja. Alberti dhe bashkëshortja e tij, Arta, kanë shpresë se një ditë

do të mund të sigurojnë një vendbanim të vetin në mesin e banesave që ka premtuar Qeveria e Kosovës për çiftet e reja. Çifti tash e një vit jeton në një banesë me qira në Prishtinë. Sipas programit

të saj, familjet përfituese do të bëheshin pronare të banesave me kështu mujore prej vetëm 120 eurosh, respektivisht 150 eurosh në muaj, për një periudhë kohore prej 150 muajsh

AGK-ja KUNDËRSHTON KUFIZIMIN E HAPËSIRËS SË PUNËS PËR MEDIET NË KUVEND

FAQE 7



ÇFARË DIHET PËR DONACIONET NË FONDIN E SIGURISË?

FAQE 7



AKTUALE



SHBA-ja BËN GATI MASAT E REJA PËR TA NDIHMUAR LUFTËN KUNDËR MOTIT EKSTREM F. 2

REMI: RAMUSH HARADINAJ NGUTET DHE BËN DEKLARATA TË CILAT NUK I BESON AS VETË SE ISHA 'TURIST' NË UÇQ F. 3

JUGU I SHQIPËRISË, NË LUFTË ME ZJARRET NË PYJE F. 3


EKONOMI



15 PUNËTORË VDIQËN NË VENDIN E PUNËS SIVJET, QINDRA TË TJERË U LËNDUAN F. 8

14 URDHËRRARRESTIME NË SHQIPËRI PËR MASHTIM ONLINE PREJ 4.7 MILIONË EUROSH F. 8

SPORT



KOREOGRAFI SKANDALOZE E TIFOZËVE SERBË NË BEOGRAD, FFK-JA ANKOHET NË UEFA F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja bën gati masat e reja për ta ndihmuar luftën kundër motit ekstrem

UASHINGTON, 27 KORRIK - Përderisa miliona amerikanë po përballeshin me nxehtësi të madhe në të gjithë pjesën jugperëndimore të ShBA-së, presidenti Joe Biden planifikon të shpallë hapa të rinj për t'i mbrojtur punëtorët, për t'i përmirësuar shërbimet e parashikimit të motit dhe për ta bërë ujën e pijshëm më të qasshëm, tha Shtëpia e Bardhë më 27 korrik.

Sekretarja e shtypit e Shtëpisë së Bardhë, Karine Jean-Pierre e përshkroi valën e të nxehtit si "një kohë të vështirë" dhe tha se Bideni po e trajtonte ndryshimin e klimës me "urgjencën e nevojshme". Presidenti demokrat ka nxitur

Departamentin amerikan të Punës t'i shtojë inspektimet e vendeve të punës potencialisht të rrezikshme, si fermtat dhe kantieret e ndërtimit. Ai, gjithashtu, kërkoi inspektime më të shpeshta në vendet e punës për të verifikuar nëse po respektoheshin masat e sigurisë së nxehtësisë.

Si pjesë e nismës, departamenti amerikan do t'i njoftojë punëdhënësit dhe punonjësit për mënyrat se si të qëndrojnë të mbrojtur nga nxehtësia ekstreme, që ka vlarë 436 punëtorë që nga viti 2011, sipas statistikave federale.

Administrata e Bidenit planifikon të shpenzojë shtatë milionë dollarë për të zhvilluar

parashikime më të hollësishme të motit në mënyrë që të parashikohet moti ekstrem, si dhe 152 milionë dollarë për ta përmirësuar infrastrukturën e ujit të pijshëm në Kaliforni, Kolorado dhe Uashington.

Udhëheqësit e Feniksit dhe San Antonios, dy qytete që kanë vuajtur nga valët e të nxehtit, pritet të marrin pjesë virtualisht në eventin e Shtëpisë së Bardhë.

Në Feniks që 27 ditë rresht janë tejkualuar temperaturat prej 43 gradë celsiusësh. Në zonën Maricopa, ku ndodhet qyteti, u raportuar së fundmi se ishin regjistruar 18 vdekje të lidhura me nxehtësinë midis 11 prillit dhe 15 korrikut. 69 vdekje të



tjera janë ende duke u hetuar. Në këtë zonë ishin raportuar 425 vdekje të lidhura me nxehtësinë gjatë vitit të kaluar. Ndërkohë, në San Antonio pati

të paktën 15 ditë rresht me temperatura mbi 38 gradë celsius. Të paktën 13 vdekje në Teksas janë fajësuar për të nxehtin ekstrem.

Tajvani ushtron zbrapsjen e një pushtimi të simuluar kinez

TAIPEI, 27 KORRIK - Trupat tajvaneze zbrapsën një pushtim të simuluar kinez në brigjet e vendit më 27 korrik. Ky aksion ishte pjesë e stërvitjeve ushtarake vjetore njëjavore të Tajvanit, ku simulohen sulme nga Pekini.

Kina, e cila e konsideron Tajvanin e vetëqeverisur si territor të saj, ka shtuar synimet e saj në vitet e fundit, duke orkestruar inkursione pothuajse ditore të avionëve luftarakë dhe anijeve detare rreth ishullit.

Luftërat e simuluar pesëditore të Tajvanit "Han Kuang" këtë vit përfshijn stërvitje në mjedis të ndryshme, përfshirë stacionin kryesor të trenit të Taipei dhe aeroportin e tij më të madh ndërkombëtar.

Stërvitja kundër pushtimit kinez më 27 korrik u zhvillua në plazhin Bali, që është një pozicion i rëndësishëm strategjik pranë kryeqytetit Taipei, tha Shih Shun-wen, udhëheqës në Teatrin e Tretë të



Operacioneve të ushtrisë tajvaneze. "Ne e dimë shumë mirë se cila është situata aktuale dhe cilat janë kërcënimet ushtarake kundër nesh", u tha Shih gazetarëve. "Ne duam ta përcjellim këtë mesazh: ne do të

bëjmë çmos për ta mbrojtur vendin tonë".

Automjetet e shënuara me ngjyrë të kuqe për të nënkuptuar se ishin kineze për qëllimet e lojërave luftarake rrotulloheshin vazhdimisht nëpër rërë, ndërsa

ushtarët me helmata të kuqe vraponin. Por, ata u penguan nga tanket dhe trupat tajvaneze. "Në të ardhmen kërcënimet dhe sfidat me të cilat përballemi do të bëhen gjithnjë e më të ndërlikuara", tha presidentja

tajvaneze Tsai Ing-wen, e cila ndoqi stërvitjen e së enjtes, e veshur me rroba të ushtrisë. Ajo, gjithashtu, mbante një maskë në fytyrë pasi u diagnostikua me Covid-19 këtë javë.

Pa e përmendur në mënyrë direkte Kinën, ajo tha se Tajvani duhej ta "parashikonte situatën e kërcënimeve hibride paraprakisht për t'i formuluar planet përkatëse dhe për t'i përmirësuar stërvitjet". "Me përpjekjet e përbashkëta të të gjithëve, ne demonstruam plotësisht qëllimin tonë luftarak për ta parandaluar armikun dhe e përfunduam me sukses këtë mision të përbashkët luftarak", tha ajo.

Qëkur Tsai, e cila nuk pranon që Tajvani është pjesë e Kinës erdhi në pushtet në vitin 2016, Pekini e ka rritur presionin ushtarak dhe politik mbi ishull.

Vitin e kaluar ushtria kineze zhvilloi dy stërvitje masive rreth Tajvanit, duke simuluar sulme të ndryshme.

ShBA-ja, 400 milionë dollarë ndihma shtesë për Ukrainën

UASHINGTON, 27 KORRIK - Shtetet e Bashkuara do t'i dërgojnë Ukrainës ndihmë ushtarake shtesë prej 400 milionë dollarësh, përfshirë raketa të mbrojtjes ajrore, dronë të vegjël dhe mjete të blinduara, njoftoi Pentagoni të martën.

Armët po sigurohen përmes një ligji që e autorizon presidentin të ofrojë ndihma ushtarake për vendet e huaja në raste emergjente. Ndihma

të tilla mund të arrijnë destinacionin pak ditë pas miratimit. Materialet do të vijnë nga inventari i tepërt i Shteteve të Bashkuara.

Njoftimi për ndihmën vjen në një kohë kur trupat ukrainase kanë ndërmarrë një kundërofensivë të ngadaltë kundër agresorit rus. Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, tha se ndihma ka për qëllim "forcimin e trupave

guximtare të Ukrainës në fushën e betejës" për t'i ndihmuar ato që ato ta rimarrin territorin sovran të Ukrainës. "Populli i Ukrainës vazhdon ta mbrojtë me guxim vendin e tij kundër agresionit rus, ndërsa Rusia vazhdon sulmet e saj të pamëshirshme dhe të egra që po vrasin civilët ukrainas dhe po shkatërrojnë infrastrukturën civile", ka theksuar Blinken në një deklaratë.



Remi: Ramush Haradinaj ngutet dhe bën deklaratatë të cilat nuk i beson as vetë se isha 'turist' në UÇK

PRISHTINË, 27 KORRIK - Epiteti i "turistit" në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës nga kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka befashuar ish-komandantin e Zonës Operative të Llapit, Rustem Mustafën.

Komandant "Remi" në një intervistë për "Albanian Post" thotë se ndryshe nga Haradinaj, të gjithë bashkëluftëtarët e tij dinë që ishte pjesëmarrës në luftë që nga dita e parë. Ai mendon se të diskutohet për këtë temë "është absurditet", teksa shprehet i bindur se kreu i AAK-së kësaj deklarate nuk i beson as vetë.

"Nuk dua të spekuloj se pse ai (Ramush Haradinaj) ngutet dhe bën deklaratatë të cilat nuk i beson as ai vetë. Unë konsideroj që të diskutojmë për këtë temë është absurditet. Pjesëmarrja ime në luftën për çlirimin e Kosovës krahas UÇK-së është, pa diskutim, pjesa më e rëndësishme e jetës time dhe nuk mund ta zhbëjë askush", ka thënë Mustafa.

Mustafa, që është jurist me profesion, ka folur edhe për mospërfshirjen veteranëve të UÇK-së në Ligjin për Pagën Minimale. Ai ka shprehur bindjen se kryeministri i



Kosovës, Albin Kurti, do t'i japë epilog kësaj çështje. "Nuk është as e nderhme as e drejtë që një luftëtar të vërtetë t'i nëpërkëmbët dinjiteti. Sapo të rregullohen evidencat, veteranët e vërtetë besoj do të kompensohen që nga dita kur Ligji për Pagën Minimale do të ketë hyrë në fuqi", u shpreh ai.

"Remi" për katër ditë me radhë ka dëshmuar këtë muaj në Gjykatën Speciale në të cilën po gjykohej ish-krerët e UÇK-së për krime lufte. Thotë se "dëshmova duke shpalosur vetëm të vërtetën". "Ndonëse me profesion jam jurist, mund të nuhas që gjithçka është sajim, trillim dhe në konkluzion

kjo gjykatë do të mbyllet e turpëruar ngase nuk ka asnjë element dhe asnjë provë që ka të bëjë me akuzat e raportit të senatorit Dick Marty mbi trafikimin e organeve apo krimeve të pretenduara që kinse ka bërë UÇK-ja". Mustafa bisedën e shefes së grupit parlamentar të Lëvizjes

Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, me kriminelin që udhëheq bandat në veri, Milan Radojiçiq, nuk e sheh "si tradhti kombëtare". "Zonja Kusari, por edhe kushdo që zgjat dorën e integritetit me të gjitha komunitetet, duke përfshirë edhe komunitetin serb, duhet përshëndetur e jo persekutuar".

Sveçla vlerëson ndihmën e UNDP-së për Kosovën



PRISHTINË, 27 KORRIK - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka pritur në takim shefin e ri të UNDP-së në Kosovë, Nuno Queiros, të cilin e ka përgëzuar për detyrën e re.

Në këtë takim ministri Sveçla ka theksuar se për Ministrinë e Punëve të Brendshme UNDP-ja është partnere e rëndësishme, ndërsa kanë diskutuar për projektet që janë duke u zhvilluar aktualisht.

Sveçla e ka falënderuar shefin e UNPD-së për mbështetjen e vazhdueshme që janë duke dhënë për Ministrinë e Punëve

të Brendshme dhe për agjencitë e saj.

Ndërsa shefi i ri në UNDP, Nuno Queiros, e ka falënderuar ministrin Sveçla për gatishmërinë e tij për ta zgjeruar bashkëpunimin edhe më tutje. Ai ka theksuar se UNDP-ja do të vazhdojë ta mbështesë MPB-në për realizimin e objektivave.

Aktualisht UNDP dhe SEESAC janë duke e mbështetur fushatën që është duke e zhvilluar Ministria e Punëve të Brendshme për parandalimin e të shtënave festive: "Festo me zemër, jo me armë".

Jugu i Shqipërisë, në luftë me zjarret në pyje

PRISHTINË, 27 KORRIK - Qindra zjarrfikës shqiptarë kanë luftuar me zjarret që kanë shpërthyer në rajonin jugor të Shqipërisë të mërkurën e 26 korrikut, përderisa një helikopter zjarrfikës ka hedhur ujë mbi flakët në pyje.

Zjarrfikësit në Qarkun e Fierit u mbështetën nga 102 pjesëtarë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe 11 automjete ushtarake u dislokuan në zonë, sipas Ministrisë shqiptare të Mbrojtjes, raporton REL. Policia ka thënë se ka parë

rritje të rasteve të zjarrvënies gjatë ditëve të fundit dhe ka identifikuar 14 njerëz të cilët janë akuzuar për ndezjen e zjarreve. Shumë fermerë në Shqipëri ua vënë flakën arave për ta pastruar kashtën, shkurret dhe mbetjet e tjera para mbjelljeve të reja.



Ambasadori Weidinger: Kosova dhe Austria kanë raporte të shkëlqyera



PRISHTINË, 27 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të enjten në takim lamtumirës ambasadorin e Austrisë në Kosovë, Christoph Weidinger. Në një takim të përzemërt dhe lamtumirës, kryeministri Albin Kurti e falënderoi ambasadorin

Weidinger për bashkëpunimin dhe angazhimin për avancimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Austrisë.

Duke vlerësuar raportet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve, kryeministri Kurti e falënderoi

ambasadorin Weidinger për kontributin në vizitat e shumta zyrtare e shtetërore, rritjen e bashkëpunimit ekonomik, mbështetjen për arsimin, të rinjtë dhe gratë dhe për mbështetjen e vazhdueshme për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Ambasadori Weidinger veçoi raportet e shkëlqyera që gëzojnë dy shtetet tona, ngrahitësinë dhe mikpritjen e njerëzve në Kosovë dhe lidhjet e shumta njerëzore në mes të Austrisë dhe Kosovës, të cilat tha se janë të gjata dhe të vazhdueshme.

Të dy kujtuan bisedat e shumta për tema të ndryshme e përtej politikës - për artin e kulturën, muzikën e filmin.

Në takim u bisedua edhe për zhvillimet aktuale në vend.

Kryeministri i uroi suksese në angazhimet e radhës.



Votohet Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, PDK-ja e AAK-ja nuk marrin pjesë në votim

PRISHTINË, 27 KORRIK - Seanca e Kuvendit të Kosovës ka nisur të enjten me vonesë. Në këtë seancë janë trajtuar pikat e mbetura nga seancat e kaluara. Në fillim të seancës janë votuar gjashtë amendamente të Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Amendamentet kaluan me 65 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Pas kësaj është hedhur në votim në lexim

të dytë Projektligji nr. 08/L-184 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Edhe Projektligji u miratua me 64 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Në votim, përveç deputetëve të LV-së, morën pjesë edhe disa nga deputetët e LDK-së. Në votim nuk morën pjesë fare deputetët e PDK-së dhe të AAK-së.

AGK-ja kundërshton kufizimin e hapësirës së punës për mediet në Kuvend

PRISHTINË, 27 KORRIK - Gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët që raportojnë nga Kuvendi i Kosovës kanë njoftuar se në seancën e së enjtes janë ballafaquar me kufizim të dukshëm të kryerjes së detyrave nga hapësira e Kuvendit të Kosovës.

Në hapësirën lart prej nga mediet raportojnë është vendosur një shirit që u pamundëson medieve ta marrin pamjen e plotë të Kuvendit dhe deputetëve.

AGK-ja e ka kundërshtuar fuqishëm këtë

vendim që, sipas saj, ka për tentim vështirësimin e raportimit profesional dhe të plotë nga Kuvendi. "Ky vendim gjithashtu nuk i kontribuon transparencës për punën e të zgjedhurve të popullit. AGK-ja fton kryesinë e Kuvendit të marrë masa për ta lehtësuar punën e gazetarëve, pasi që raportimi i tyre nga Kuvendi është në interes të publikut. Si pasojë e këtij vendimi, gazetarët në fund të seancës së sotme janë larguar nga punimet e Kuvendit", është theksuar në reagimin e AGK-së.





Çiftet e reja në pritje të banesave të premtuara nga Kurti

Qeveria aktuale e Kosovës, e cila është zgjedhur në mars të vitit 2021, ka premtuar ndërtimin e 4 000 njësive banesore për çiftet e reja. Alberti dhe bashkëshortja e tij, Arta, kanë shpresë se një ditë do të mund të sigurojnë një vendbanim të vetin në mesin e banesave që ka premtuar Qeveria e Kosovës për çiftet e reja. Çifti tash e një vit jeton në një banesë me qira në Prishtinë. Sipas programit të saj, familjet përfituese do të bëheshin pronare të banesave me këste mujore prej vetëm 120 eurosh, respektivisht 150 eurosh në muaj, për një periudhë kohore prej 150 muajsh

PRISHTINË, 27 KORRIK - Alberti dhe bashkëshortja e tij, Arta, kanë shpresë se një ditë do të mund të sigurojnë një vendbanim të vetin në mesin e banesave që ka premtuar Qeveria e Kosovës për çiftet e reja. Çifti tash e një vit jeton në një banesë me qira në Prishtinë. "Nëse do të na mundësohej blerja e banesës sipas planit të qeverisë, për ne do të ishte një zgjidhje jetësore", thotë Alberti për "Radion Evropa e Lirë". Qeveria aktuale e Kosovës, e cila është zgjedhur në mars të vitit 2021, ka premtuar ndërtimin e 4 000 njësive banesore. Sipas programit të saj, familjet përfituese do të bëheshin pronare të banesave me këste mujore prej vetëm 120 eurosh, respektivisht 150 eurosh në muaj, për një periudhë kohore prej 150 muajsh. Përparësi do të kishin çiftet e reja, të cilat kanë mundësi të

limituara financiare për të blerë banesa me çmime të tregut. Ndonëse kanë kaluar më shumë se dy vjet prej se ky premtim është bërë formal, ndërtimi i këtyre banesave nuk ka filluar. Në Qeverinë e Kosovës thonë për "Radion Evropa e Lirë" se kanë hartuar tashmë draftin e ri të projektligjit, sipas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit për programin e banimit social adekuat për Kosovën. Thonë, po ashtu, se gjatë muajit gusht synojnë "ta kompletojnë koncept-dokumentin, për të vazhduar më tutje finalizimin e draft-ligjit". Por, nuk japin asnjë detaj se kur mund të nisë dhe përfundojë ndërtimi i banesave. Në shkurt të këtij viti Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Kosovës dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare kanë nënshkruar një

marrëveshje për studim të fizibilitetit për banim dhe kosto të përballeshme. Kostoja e ndërtimit për këtë projekt është thënë se sillet rreth 200 milionë euro.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë asokohe se projekti do të fillojë të zbatohet gjatë këtij viti. "Si Qeveri do ta bëjmë të pamundurën që projekti i planifikuar për ndërtimin e 4 000 njësive banesore të realizohet sa më shpejt që është e mundur", ka thënë Kurti.

Ndërtimi i banesave do të bëhej në komunat më të mëdha: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan.

Larg zbatimit të premtimit

Brahim Selimaj, pronar i një kompanie ndërtimesh në

Kosovë, thotë për Radion Evropa e Lirë se ndërtimi i 4 000 njësive banesore nuk mund të realizohet brenda mandatit të mbetur të qeverisë. "Në kushtet e Kosovës, kur duhet të pritet një apo dy vjet për një leje ndërtimi, është e pamundur të realizohet [ky premtim] në mandatin e parë [të qeverisë]. Ndërtimi i 4 000 njësive banesore mund të zgjasë minimumi dy vjet. Ndërtimi mund të zgjasë edhe pesë vjet", thotë Selimaj. Për më tepër, shton ai, kostoja e ndërtimit ka shënuar rritje krahasuar me tre vjet më parë. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se indeksi i tërësishëm i kostonë së ndërtimit ka pësuar rritje për 3.3 për qind në tremujorin e parë të vitit 2023 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2022.

Çmimet në treg të patundshmërive

Rritje të çmimeve kanë pësuar pothuajse të gjitha produktet e konsumit. Vitin e kaluar Kosova e ka përmbyllur me normë mesatare të inflacionit gati 12 për qind. Alberti, i cili punon në hoteleri

në sektorin privat dhe paguhet rreth 500 euro në muaj, thotë se paguan 250 euro qira dhe se e ka të pamundur që me çmimet aktuale në treg, të blejë banesë. "Me këto çmime të banesave sa sillen në treg, 1 000 euro metri katror, edhe 100 vjet nëse punoj në këtë punë, nuk arrij ta blej. Për një kredi, kësti mujor është 500 euro", thotë ai.

Për një banesë të re në Prishtinë, varësisht lokacionit, blerësi duhet të paguajë nga 900 euro deri në mbi 2 500 euro për metër katror.

Çmimet janë të ngjashme edhe në Prizren - rreth 85 kilometra larg kryeqytetit - ndërsa pak më të ulëta janë në qytetet e tjera, si: Fushë-Kosovë, Ferizaj, Gjilan dhe Pejë.

Përfaqësues të agjencive të patundshmërive kanë thënë më herët për REL-in se nuk presin që çmimet e banesave të reja të shënojnë rënie gjatë këtij viti marrë parasysh faktin se ato janë ndërtuar me material më të shtrenjtë.

Me planin e qeverisë për 4 000 banesat e reja, çmimi i një banese prej 60 metrash katrorë do të sillet nga 18 000 euro deri në 22 500 euro.

Murtaja afrikane e derrit përhapet në Dragash

DRAGASH, 27 KORRIK - Murtaja afrikane e derrit është përhapur edhe në Dragash, ka njoftuar komuna. "Ju informojmë se në territorin e komunës sonë tashmë edhe zyrtarisht është konfirmuar 'Murtaja afrikane e derrit'.

Shoqata e Gjahtarëve 'Dhia e Egër' së bashku me Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Dragash, si dhe institucionet relevante qeveritare, janë duke ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për eliminimin e

kësaj sëmundje. Kjo sëmundje nuk transmetohet te kafshët e tjera, as te njeriu, mirëpo kujdesi duhet të jetë maksimal, pasi më herët nuk kemi pasur raste të tilla", ka njoftuar komuna e Dragashit.



Në Prizren shfaqet filmi i metrazhit të gjatë "Lost lives"

PRIZREN, 27 KORRIK - Nën organizimin e Ambasadës së Britanisë së Madhe në Kosovë dhe "DokuFest"-it, në "DokuKino" u shfaq filmi i metrazhit të gjatë "Lost lives" (Jetët e humbura), i frymëzuar nga libri me të njëjtin emër, që premierën e kishte në vitin 2019, në 50-vjetorin e fillimit të konfliktit të armatosur në Irlandën e Veriut. Pas filmit, në një panel për të diskutuar për këtë vepër artistike dokumentare, u tha se libri "Lost lives" është i vetmi që ka regjistruar të gjitha viktimat e

kësaj tragjedie njerëzore, 3 700 jetë të humbura, dhe shërben si një kujtesë e qëndrueshme se pse Irlanda e Veriut nuk duhet të kthehet më në konflikt në shkallë të gjerë. "Falënderoj ambasadorin e Britanisë së Madhe, Nicholas Abbott, për këtë iniciativë dhe për mundësinë që i dha publikut prizrenas të përjetoj një moment të jashtëzakonshëm përmes kësaj ngjarjeje kinematografike që trajton të shkuarën duke shikuar nga e ardhmja", u shpreh kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj.



Mbahet sesion trajnimi për zyrtarët komunalë të Departamentit Ligjor të Podujevës

PODUJEVË, 27 KORRIK - Në komunën e Podujevës është mbajtur sesion trajnimi për zyrtarët nga konsulenti ligjor Kamber Gjaka, i angazhuar në kuadër të projektit "Veprimi i komunave për riintegrimin dhe diasporë", - Mardë, të financuar

nga Caritasi Zvicran dhe zbatuar nga Germin. Gjatë sesionit të trajnimit Gjaka ka diskutuar për zhvillimin e kapaciteteve dhe praktikave mira (best practice ACD), duke ndarë njohuritë dhe përvojën e tij në proceset vendimmarrëse në

nivelin lokal. Kamberi në kuadër të këtij projekti do të jetë i angazhuar si konsulent ligjor gjatë një muaji në Zyrën ligjore në Komunën e Podujevës për të ofruar asistencë, rekomandime dhe praktika të mira në fushën përkatëse.

Përurohen edhe 100 parkingje të reja në Drenas



DRENAS, 27 KORRIK - Komuna e Drenasit ka përuar edhe 100 parkingje të reja, të cilat do të jenë në dispozicion për shfrytëzim nga qytetarët e Drenasit, krahas 350 parkingjeve që u përuan javë më parë, e që gjithsej arrijnë shifrën prej 450 parkingjeve të reja. Krahas kësaj pune, është bërë edhe asfaltimi i pjesës rrugore që lehtëson kycjen e automjeteve në qendrën e qytetit. "Kjo duke u nisur nga evidentimi që kemi bërë

në terren, kemi evidentuar si një ndër problemet bazike me të cilën përballëshin qytetarët ishte mungesa e hapësirave për parkimin e veturave. Krahas kësaj është bërë asfaltimi i pjesës rrugore që lehtëson kycjen e automjeteve në qendrën e qytetit. "Kjo duke u nisur nga evidentimi që kemi bërë njoftimin e komunës së Drenasit.

Drenasi përkrah Zveçanin në disa fusha

DRENAS, 27 KORRIK - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe kryetari i komunës së Zveçanit, Ilir Peci, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, me ç'rast komuna e Drenasit do t'i

ofrojë përkrahje administrative në disa fusha komunës së Zveçanit. "Jam i lumtur që së bashku me drejtorët dhe administratën e komunës tonë të ofrojmë përkrahje dhe shërbime për të

avancuar qeverisjen aktuale në Zveçan, në shërbim të qytetarëve dhe interesit shtetëror për funksionimin e pushtetit lokal në tërë Republikën e Kosovës", ka shkruar Lladrovci në "Facebook".



Çfarë dihet për donacionet në Fondin e Sigurisë?



PRISHTINË, 27 KORRIK - Ka më shumë se një vit që është themeluar, por se sa është vlera e Fondit të Sigurisë së Kosovës nuk dihet dhe nuk bëhet publike.

Në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Kosovës, e cila i menaxhon mjetet e Fondit, thonë se ato “janë transparente dhe në dispozicion për autoritetet shtetërore që kanë të drejtë të qasjes”, por nuk tregojnë se cilat institucione e kanë këtë të drejtë. Nga Ministria e Mbrojtjes e Kosovës, në anën tjetër, thonë se këto mjete do të investohen për “përmbytjen e objektivit kryesor, që është garantimi i sigurisë së qytetarëve dhe i mbrojtjes territoriale”.

Qeveria e Kosovës ka themeluar Fondin e Sigurisë në mars të vitit të kaluar, ku qytetarë dhe donatorë të ndryshëm mund të kontribuojnë përmes një xhironlogarie bankare.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë në atë kohë se ky fond është

themeluar duke u bazuar në nevojat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila është në proces të shndërrimit në ushtri, si dhe pas konsultimeve me partnerët ndërkombëtarë.

Paratë e mbledhura në këtë fond, sipas qeverisë së Kurtit, do të shkojnë si buxhet shtesë për Ministrinë e Mbrojtjes.

Sa është buxheti për mbrojtje?

Ministria e Mbrojtjes e Kosovës konfirmon për Radion Evropa e Lirë se buxheti i ndarë për mbrojtje këtë vit është 141.2 milionë euro, ndërsa investimet në armatim, sipas saj, janë trefish më të larta në krahasim me dy vjet më parë.

Ministria nuk ofron më shumë detaje, por ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, thotë se me mjetet e Fondit të Sigurisë FSK-ja duhet

të sigurojë pajisje individuale, armatim, rritje të personelit dhe investime në infrastrukturë. “Duke pasur parasysh se sfidat e sigurisë rajonale dhe globale janë duke sfiduar edhe ushtrinë e Kosovës që të ecë më shpejt përpara, për t’i avancuar kapacitetet e veta, atëherë është e nevojshme që edhe buxheti të rritet dhe të jetë më i madh sesa mund të ndajë Qeveria e Kosovës”, thotë Kastrati për Radion Evropa e Lirë.

Thirrje për donacione

Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, në “Facebook” më 17 korrik u ka bërë thirrje qytetarëve të kontribuojnë në Fondin e Sigurisë. “Ushtria jonë, përmes investimit në armatim dhe pajisje të tjera ushtarake, po konsolidohet në vazhdimësi. Që të jetë edhe më e fortë për të garantuar një Kosovë më të sigurt, të gjithë ju, qytetarë të dashur,

mund të kontribuoni duke dhuruar në Fondin e Sigurisë, në llogarinë aktive brenda apo jashtë vendit”, ka thënë Mehaj. Dhjetëra qytetarë kanë komentuar poshtë këtij postimi - disa prej të cilëve kanë shprehur edhe dëshmi të parave të deponuara në llogarinë e Fondit të Sigurisë. Shumat e tyre sillen nga 10 deri në mbi 1 000 euro.

Kastrati, i cili ka udhëhequr FSK-në nga viti 2011 deri më 2015, thotë se shuma e grumbulluar në Fondin e Sigurisë duhet të bëhet publike për qytetarët.

“Secili qytetar që jep donacione për këtë fond duhet ta dijë se sa mjete janë mbledhur. Nuk ka nevojë ta dinë ata se ku po shkojnë, sepse blerja e pajisjeve dhe armatimeve të ndryshme është konfidenciale, por duhet ta dinë vlerën e mjeteve të grumbulluara”, thotë Kastrati.

Edhe disa organizata joqeveritare kanë shprehur më herët

shqetësim për mënyrën se si jepen paratë në Fondin e Sigurisë. Për të pasur transparencë, sipas tyre, fondi do të duhej të rregullohej me ligj.

Qeveria e Kosovës ka njoftuar më 17 korrik se ka blerë dronë Bayraktar TB-2 nga Turqia. Autoritetet nuk kanë treguar numrin e dronëve të blerë e as çmimin e tyre, por kanë thënë se me blerjen e tyre Kosova “është edhe më e sigurt”.

Forca e Sigurisë e Kosovës nga viti 2018 është në proces të shndërrimit në ushtri.

Është e paraparë që deri në vitin 2028 ajo t’i arrijë të gjitha kapacitetet operacionale për, siç thuhet, “ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës si dhe të qytetarëve, pronave dhe interesave të vendit”.

FSK-ja aktualisht ka rreth 2 500 pjesëtarë. Pas periudhës së tranzicionit, ky numër pritet të rritet në mbi 7 500 dhe të përfshijë pjesëtarë aktivë dhe rezervistë.

FSK-ja dhe Iowa, aktivitete të përbashkëta

PRISHTINË, 27 KORRIK - Forca e Sigurisë së Kosovës në kuadër të partneritetit me Gardën Kombëtare të Iowas ishte pjesë në Ditën e Vizitorëve të Shquar (Distinguished Visitors Day) e JRTC (Joint Readiness Training Center) Training Rotation, Fort Johnson, Louisiana, ShBA, ku

pjesë e njërive të Gardës Kombëtare të Iowas ishin edhe gjashtë pjesëtarë të Regjimentit të Parë të Forcave Tokësore (R1K), të cilët ndan përvojat e tyre në këtë aktivitet të rëndësishëm të Ushtrisë Amerikane.

R1K është i binjakëzuar me Batalionin 133 të Këmbësorisë

së Gardës Kombëtare të Iowas, që nga viti 2022 dhe deri më tani janë realizuar aktivitete të ndryshme ushtarake në të dyja vendet dhe ky ishte aktiviteti i radhës i cili thelloi edhe më tej bashkëpunimin ndërmjet dy njërive e që do të vazhdojë trajnime dhe aktivitete të tjera në të ardhmen.



15 punëtorë vdiqën në vendin e punës sivjet, qindra të tjerë u lënduan

PRISHTINË, 27 KORRIK - Vetëm në gjashtëmuorin e parë të këtij viti nga lëndimet e marra në vendin e punës kanë vdekur 15 persona.

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka thënë për Express se, përveç rasteve që përfundojnë me fatalitet, ka edhe qindra raste të tjera të lëndimeve. Madje Azemi tha se ka raste kur punëtorët e kompanive private u bëjnë presion punëtorëve të lënduar që të mos i lajmërojnë rastet në polici. "Asnjëherë nuk mund të ketë një shifër të saktë sepse ka lëndime të përgjithshme, ndoshta me qindra lëndime

brenda ditës. Për lëndimet pronarët e kompanive u bëjnë presion punëtorëve që mos të deklarohen se janë lënduar në vendet e tyre të punës, por në një vend diku tjetër. Sa iu përket rasteve të vdekjeve, sivjet është numri më i madh prej se ne i kemi statistikën, po flasim për periudhën gjashtëmuore. Nëse mund të themi tani edhe për muajin korrik, kemi 15 raste të vdekjeve në vendet e tyre të punës. Realisht në vitin e kaluar, 2022 dhe 2021, nuk ka qenë ndërtimtaria prioritet, por këtë vit kryesisht rreth 70 % e këtyre punëtorëve kanë vdekur në ndërtimtarë", ka

thënë Azemi.

Nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) kanë thënë se punëtorët më të rrezikuar në vendin e punës janë ata të ndërtimtarisë.

Për t'i evituar rastet e lëndimit dhe vdekjeve në vendin e punës është duke u kërkuar shtimi i inspektorëve në terren.

Nga KMDLNj thonë se duhet të ketë edhe gjoba më të larta.

Policia e Kosovës ka konfirmuar për Express se lidhur me veprën penale "Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës", në tre muajt e parë të këtij viti janë hapur 39 raste.



Rafuna merr çmimin për lider në përmirësim të ambientit për investime dhe edukim të fuqisë punëtore

PRISHTINË, 27 KORRIK - Kryetari i Odës së Maqedonisë së Veriut, Branko Azeski, ka pritur kryetarin e OEK-ut, Lulzim Rafuna, për t'i dhënë çmimin për lider në përmirësim të ambientit për investime dhe edukim të fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor sipas nevojave të tregut të punës.

Ai shprehu mirënjohjen për punën e deritanishme të kryetarit Rafuna si udhëheqës i Odave të Ballkanit Perëndimor (WB6 CIF) ku përfaqëson rreth 350 000 biznese dhe uroi që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ndërkaq kryetari Rafuna u shpreh mirënjohës për këtë çmim. "Është një nder i veçantë për mua, por edhe më shumë për Odën Ekonomike të Kosovës, të marr këtë



shpërblim dhe mirënjohje në Forumit të Investimeve të 6 cilësinë e presidentit të Dhomave të Ballkanit

Perëndimor dhe si kryetar i OEK-ut dhe të dëgjosh për

arritjet konkrete të nismës. Është vërtet kënaqësi të shohësh se sa shumë kompani nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe i gjithë Ballkani Perëndimor kanë përfituar nga puna e WB6 CIF", ka theksuar Rafuna.

Ai ka thënë se ky është një inkurajim për CIF të WB6 që t'i rrisë ambicet për t'i mbështetur ekonomitë e rajonit dhe për t'i afruar ato me njëra-tjetrën dhe me tregun e BE-së. "Shpresoj se është gjithashtu një inkurajim për bizneset e rajonit që të kërkojnë mbështetje dhe bashkëpunim të mëtejshëm me odat e tyre përkatëse të tregtisë dhe me ne si Forum i Investimeve i 6 Dhomave të Ballkanit Perëndimor", u shpreh Rafuna.

14 urdhërarrestime në Shqipëri për mashtrim online prej 4.7 milionë eurosh

TIRANË, 27 KORRIK - Drejtues dhe punonjës të një qendre të thirrjeve në Shqipëri kanë mashtruar qytetarë italianë duke përfituar 4.7 milionë euro, sipas Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar (SPAK). Lidhur me aktivitetet e kësaj qendre të thirrjeve, SPAK-u ka lëshuar urdhërarrestime për 14 persona. Për nëntë prej tyre është caktuar masa e sigurisë "arrest me burg", ndërsa për pesë të tjerë "arrest shtëpiak". Qendra e thirrjeve ndodhej në rrugën "Dritan Hoxha" në Tiranë.

SPAK bashkëpunoi me prokurorinë e Pordenones,

komunë në Itali, dhe operacioni i koduar "Dream earnings" është vijim i një operacionit të nisur në tetor të vitit 2022. "Janë administruar 140 kallëzime të personave të dëmtuar në Itali dhe shuma e parave që ata kanë humbur shkon deri në 4.7 milionë euro", ka deklaruar prokurori i SPAK-ut, Eneid Nakuçi.

Prokurorja italiane Maria Grazia Zaina tha se nga hetimet ka rezultuar se mashtruesit ishin mjaft të aftë në përdorimin e teknikave reale bindëse aq sa kishin arritur t'i bindnin qytetarët e pafajshëm të investonin gjatë

kësaj kohe qindra mijëra euro në llogari rrjedhëse jashtë shtetit.

Fillimisht, ata bindeshin të investonin në shuma të vogla parash dhe më pas i stimulonin të investonin në shuma të mëdha, duke i bërë të besojnë se do të fitonin gjithnjë e më shumë. Prokurori Eneid Nakuçi tha se paratë e përfituara shkonin në kriptovalutë dhe në llogari të huaja të pagjurmueshme. Gjatë konferencës për shtyp u bë me dije se janë kryer rreth 42 000 përgjime dhe ka rezultuar se paratë pastroheshin në vende si Qipro, Lituani, Estoni,



Holandë, Gjermani dhe ishin konvertuar në kriptovalutë. "Në çdo transferim në hyrje rezultonte dhënia e një sasive BitCoin (kriptovalutë) në

favor të një portofoli të panjohur duke humbur në këtë mënyrë gjurmët e parave", ka theksuar prokurori Nakuçi.

Thëniet e Faik Konicës, aktuale edhe sot



Nga: Frank SHKRELI

Klasës politike aktuale shqiptare dhe të gjithë shqiptarëve kudo, Faik Konica u thotë:

“Duke parë dhe duke dëgjuar, bota mësojnë mend dhe ndërtohen. Ne shqiptarët, s’marrim dot mësim; malet të tunden dhe të rrëkëllehen, ne nuk këmbëjmë mënyrën tonë. Mbani mirë (mend) këtë që po ju them: në njëqind vjet, në vafshim si po vemi, do të jemi aq poshtë sa edhe sot”.

“Sa e sa marrëzi, sa e sa poshtërsi e krime janë bërë në emër të së gjoës Shqipëri”.

“Armiqtë e Shqipërisë janë shqiptarët, jo të tjerë. Shqiptarët kanë shkruar me gjakun e tyre më tepër se një faqe në histori të Evropës.”

Gjithë shqiptarët kudo dhe pa dallim, Faik Konica do i këshillonte:

“Të përpiqemi me të gjitha forcat tona të shërojmë shqiptarët nga dashuria për individët. Ata duhet të mësojnë të duan Shqipërinë – jo për t’i bërë qejfin këtij apo atij shqiptari”. (Albania’ 16, 15-30 korrik 1898).

Për ata që thonë se 30-vjet post-komunizëm nuk

mjaftojnë për të vendosur një demokraci të vërtetë perëndimore, Faik Konica u thotë:

“Tek prisnim të piqeshin kushtet, na u kalbën dëshirat.” *“Politika e vërtetë qëndron në kapjen e drejtimit të një evolucioni të caktuar dhe në përpjekjen për të ndihmuar në përsheptimin e fundit të tij”.* (Albania’ 11, 1898).

Për ata që rininë e quajnë “huliganë”, Faik Konica u thotë:

“Rinia është në sytë e injorantëve kërcënim për të ardhmen; por është edhe rrezik për të tashmen, sepse rinia është e çiltër, ndërkohë që dhe çiltërsia është armiku i natyrshëm i sharlatanëve”. (Albania’ 5, 1905).

“Populli është i duruar, po gjer në një pikë: e kur kupton dhe e zë zenga, tërbimi i tij bën çudira të shëmtuara”.

Për ata që nuk kuptojnë ose nuk duan të pranojnë zemërimin e njerëzve, në kohë të vështira, Faik Konica u thotë:

“Si mos të dëshpërohesh në këtë vend, ku të pasurit nuk ndihmojnë dhe të varfërit nuk punojnë”?

Për opinionistët dhe analistët e TV-studiove të sotme

shqiptare, Konica do të thoshte:

“Shumica e atyre që kanë marrë mbi vete misionin modest të ndriçojnë opinionin publik’ as që kanë ndjesinë më elementare ta nisin fillimisht nga vetvetja për t’u mirinformuar. Venë e venë në përdorim mënyra hulumtimi të cilat, sikur të zbatoheshin në çdo shkencë, do bënë për të qeshur edhe një nxënës shkollë” (Albania’ 6, 1905).

“Frikacaku i ka tërë karakteristikat, dhe kryesisht këtë: hakmerret ndaj përbuzjes së tjetrit nëpërmjet sharjes. I pafuqishëm, veç flet keq e shan poshtërsisht të tjerët”. (Albania’ 5, 1905).

“Ka njerëz që shitën në guverna për të pështyr gënjeshtër. Ka të tjerë që marrin ndihmë nga një guvernë për të thënë të vërteta që ndryshe nuk mund t’i thonë”. (Albania’ 2, 1899).

“Ka pasur në çdo kohë, dhe përherë do ketë individë të gatshëm për të folur e shkruar lidhur me çështje për të cilat nuk ia kanë haberin të shprehin as fjalën e parë. Por për mendjet e matura, të etura për të studiuar seriozisht një vend e një popull, nuk ka dhe nuk do të ketë veçse dy metoda

në përdorim, jashtë së cilave gjithçka tjetër nuk është veçse mashtrim: metoda e parë ka të bëjë me ndërmarrjen e udhëtimeve për të bërë anketime të hollësishme e sistematike drejtpërdrejt në vend; e dyta, me leximin sa më shumë që të jetë e mundur të broshurave e librave të lidhura me çështjen konkrete, me qëllim që të arrihet nëpërmjet induksionit – përmes një morie dokumentesh, faktesh dhe pohimesh kontradiktore – të veçohet e vërteta dhe të koordinohet një tërësi pikëpamjesh të qarta e objektive” (Albania’ 6, 1905).

Akademikëve dhe studiuesve, Faik Konica u thotë:

“E vërteta nuk ka nevojë për stil gjarpërues e të yndyrshëm të shkrimeve akademike”. (Albania’ 2, 1897).

Atyre që bëjnë sehir ndaj të këqijave të shoqërisë, urrejtjeve dhe armiqtësive, Faik Konica u thotë:

“Urrejtja nuk çarmatoset nëpërmjet heshtjes e asnjësisë” (Albania’ 12, 1909).

“Një i mbushur me mllef e mëri, në mendjen e tij anemike, rrokullis mendime të tmerrshme”. (Albania’ 9, 1898).

Apologjetëve të komunizmit të

Enver Hoxhës, 30-vjet post-komunizëm, Faik Konica u thotë:

“Dallimi në kulturë shpjegon dallimin në mendime” – “Nuk mund të pretendosh të përfitosh nga tërë dobitë e lirisë, duke ruajtur njëkohësisht tërë privilegjet e tiranisë. Për të pasur institucione të lira, duhen luftuar mendimet nëpërmjet mendimeve”. (Albania’ 5, 1907).

“Të verbrit do të mbeten të verbër in sæcula sæculorum (gjer në fund të botës); edhe sikur t’u shtini perona në sy, ata prapë nuk do shohin kurrjë”. (Albania 1, 1897).


Përfaqësuesve të partive politike shqiptare, Faik Konica do u thoshte të mënjanojnë urrejtjet:

“Urrejtja partiake shpesh merr përparësi ndaj instinktit kombëtar”. (Albania’ 2, 1904).

Atyre që po shkatërrojnë bukuritë e natyrës së Shqipërisë (Valbona, Vjosa) për përfitime ekonomike, Faik Konica u thotë mos urreni bukuritë që Perëndia u ka falur shqiptarëve:

“Shqipëria është një vend i bekuar me njëmijë bukurira, shkelur nga turmë e cila ushqen njëfarë urrejtje ndaj bukurisë”.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Koreografi skandaloze e tifozëve serbë në Beograd, FFK-ja ankohet në UEFA

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 KORRIK - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) e dënon ashpër dhe njëherësh shpreh zemërimin dhe shqetësimin e saj lidhur me koreografinë skandaloze, luftënxitëse të tifozëve të klubit serb, Crvena Zvezda, në ndeshjen e futbollit kundër Fiorentinës në Beograd. "Paraqitja e një tanku si koreografi në tribuna me simbolikën kundër Kosovës është një akt i papranueshëm dhe i pashoq për sportin, por edhe për harmoninë e paqen ndërmjet vendeve dhe popujve në rajonin tonë, e sidomos në periudhën e tensioneve mes dy vendeve. Ky akt i shprehur publikisht, i shoqëruar edhe me slogane provokuese, dëshmon se opinioni në Serbi dhe autoritetet e atjeshme nuk kanë ndryshuar aspak nga qasja agresore dhe njëherësh është një provokim i hapur ndaj sportit të futbollit dhe Republikës së Kosovës", thuhet në reagimin e FFK-së.

Federata e Futbollit e Kosovës ka vepruar në përputhje me rregulloret dhe parimet e UEFA-së, duke paraqitur ankesë zyrtare për këtë çështje. "Ne kemi kërkuar nga

organet e UEFA-së që ta hetojnë me urgjencë këtë rast dhe të marrin masa të ashpra ndaj klubit dhe tifozëve të Crvena Zvezdës, në mënyrë që veprimet e tilla shoviniste dhe provokimet e ngjashme të parandalohen në të ardhmen. Futbollit është sport që përveç argëtimit duhet t'i afrojë njerëzit dhe të shërbejë për ndërtimin e urave të bashkëpunimit. Koreografitë dhe sloganet e tilla që synojnë të shkaktojnë konflikte dhe urrejtje ndërmjet vendeve dhe popujve nuk duhet të tolerohen", thuhet në reagimin e federatës kosovare. Sipas FFK-së, pas këtij rasti urgjentisht duhet të reagojnë organet e UEFA-s dhe të FIFA-s dhe të japin masa më të ashpra kundër shkeljes së parimeve dhe vlerave bazë të lojës së futbollit: "Shpresojmë dhe besojmë që ankesa e reagimi jonë do të merret seriozisht dhe ata që nxisin urrejtje ndërmjet futbollit do të ndëshkohen".

FFK-ja është zotuar se do të vazhdojë t'i promovojë vlerat e vërteta të futbollit, pasi është e vetëdijshme se një mjedis i sigurt dhe i respektueshëm në stadione është thelbësor për ta përjetuar emocionin e futbollit në mënyrë pozitive.



Çeku: Serbia mobilizon tifozët për mesazhe lufte

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka reaguar lidhur me veprimin e fundit të tifozëve serbë. Numri një i sportit në Kosovë ka thënë se koreografia e organizuar në ndeshjen miqësore të futbollit të zhvilluar të mërkurën ndërmjet "Yllit të kuq" dhe Fiorentinës në Beograd tregon qartazi për mendësinë e

pandryshuar të Serbisë. "Grupi i tifozërisë 'Delije' ka shfaqur një koreografi ku shihet një tank i madh me sfondin e flamurit serb dhe me shkrimin nën të 'Kur të kthehet ushtria në Kosovë'. Serbia edhe një herë tregoi që nuk e kursen as sportin si platformë për promovimin e politikës së saj luftënxitëse. Kërcënimet me luftë

nga stadiumi i futbollit duhet të kundërshtohen nga organizatat ndërkombëtare të futbollit, të cilat i ftojmë për marrjen e masave të duhura ndëshkuese. Këto veprimeve të Serbisë janë të papranueshme, andaj komuniteti ndërkombëtar nuk duhet të qëndrojë në heshtje", ka thënë ministri Çeku.

Shabani: Krenar që isha pjesë e sukseseve historike me klubin e vendlindjes

"Epoka e re"

PRISHTINË, 27 KORRIK - Skuadra e Llapit ka ndarë rrugët me mesfushorin Kushtrim Shabani i cili djersiti fanellën e kësaj skuadre në tri vitet e fundit. Bashkëpunimi është ndërprerë me marrëveshje të dyanshme. "Pas një takimi të drejtorit sportiv, Mentor Zhdrella dhe futbollistit u vendos që të ndërpritet bashkëpunimi këtu. Falënderojmë futbollistin Kushtrim Shabani për kontributin e dhënë për klubin si dhe i dëshirojmë suksese në vazhdim të karrierës", thuhet në



njoftimin e Llapit.

Në anën tjetër, futbollisti Shabani ndihet krenar me të arriturat që ka pasur me skuadrën e Llapit. "Çdo fillim e ka një fund, njësoj edhe rrugëtimit tim si futbollist i KF Llapit i erdhi fundi. Pas një periudhe të gjatë dhe shumë të

suksesshme si futbollist i klubit Llapit, me marrëveshje të dyanshme me klubin vendosëm të ndërprisim bashkëpunimin. Jam krenar për periudhën e kaluar me klubin e vendlindjes sime dhe që isha pjesë e sukseseve historike të këtij klubi, ku me mund, djersë e shumë sakrificë udhëhoqa ekipin si kapiten", ka thënë Shabani, i cili më pas i ka falënderuar të gjithë anëtarët e klubit, tifozët "Ultras Legjendat" për mbështetjen që i kanë dhënë atij dhe klubit. "Klubit i dëshiroj shumë suksese në vazhdim, ndërsa për të ardhmen time do vendosi ditëve në vijim", ka shtuar Shabani.

Kosova për herë të parë luan në Zvicër, FBK-ja kërkon mbështetjen e bashkatdhetarëve

PRISHTINË, 27 KORRIK - Kosova për herë të parë do të luajë në Zvicër në basketboll. "Dardanët" do të përballen me "Helvetikët" të shtunën nga ora 17:30 në Fribourg, përkatësisht palestren "Site Sportif Saint-Leonard". Kjo është një mundësi e mirë për bashkatdhetarët tanë që jetojnë në Zvicër, t'i shohin nga afër basketbollistët "dardanë". "FBK-ja fton shqiptarët që jetojnë në Zvicër t'i mbështesin basketbollistët e Kosovës, pasi është sfidë jetike", thuhet në njoftimin e Federatës së Basketbollit.



Kosova është përballur me Zvicrën në Prizren, ku edhe arriti fitore me rezultat 76:49. Kosova ka një fitore e një humbje, Danimarka dy fitore dhe Zvicra dy humbje në Grupin H të Rrethit të Tretë Parakualifikues për "Eurobasket 2025".

Luiza Gega pushtoi Serbinë, atletja mori tri medalje të arta

TIRANË, 27 KORRIK - Pasi arriti ta fitonte garën e 3 000 metrave me pengese, Luiza Gega arriti ta siguronte medaljen e tretë të artë në Kampionatin Ballkanik që po mbahet në Serbi. Në "Instagram" sportistja shqiptare shpreh lumturinë për këtë sukses. "Çdo

medalje ka rëndësi dhe e lumtur që arrita të marr 3 të arta për Shqipërinë në Kampionatin Ballkanik, që u zhvillua në Serbi. Vetëm në garën 3000 metra me pengesa tentova të vrapoj pak më shpejt për të kapur kohën e normës olimpike, duke realizuar kohën 9.21.

Zyrtarisht preva biletën për në 'Paris 2024'. Dy garat e tjera 3000m dhe 5000m ishin thjesht gara taktike për të fituar medaljen e artë, por me një finish të shpejtë, pasi doja të ndjeja që në këmbët e mia ende ka forcë, edhe pse po bëja 3 gara për dy ditë", ka shkruar Gega.



Silva pensionohet nga futbollit

DONOSTIA-SAN SEBASTIAN, 27 KORRIK - David Silva ka njoftuar për pensionimin e tij nga futbollit profesional pasi që pësoi një lëndim të tmerrshëm në stërvitje. Legjenda e Manchester City, Silva, edhe zyrtarisht ka njoftuar për

pensionimin e tij në moshën 37-vjeçare, disa javë para se të fillojë sezoni i ri. Silva kishte nënshkruar një kontratë të re njëvjeçare me Real Sociedadin në muajin prill. Ai e ndihmoi Sociedadin të rikthehet në kualifikimet e Ligës së

Kampionëve për herë të parë pas 10 vjetëve. "Sot është një ditë e mërzitshme për mua. Sot është dita kur i them lamtumirë asaj që ia kam dedikuar të gjithë jetën time. Sot është koha kur i them lamtumirë kolegëve të mi, të

cilët janë si familje për mua. Do të më mungoni shumë. Ches. Armeros. Celtinas. Citizens dhe Txuri Urdines. Faleminderit sepse ju më bëtë të ndihem në shtëpi", ka thënë Silva përmes një videomesazhi.



NBA legalizon përdorimin e marijuanës

UASHINGTON, 27 KORRIK - NBA ka marrë një vendim, duke hequr marijuanën nga lista e substancave të ndaluara, duke lejuar përdorimin e saj nga basketbollistët. Vendimi i marrë që në prill hyri në fuqi nga korriku i këtij viti. Kështu, nuk do të ketë më gjoba, kontrolle apo dënime për lojtarët që përdorin marijuanën. Ai që e bindi komisionarin Adam Silver të marrë këtë vendim ishte basketbollisti Kevin Durant. Papritur, ai u kthye në një avokat mbrojtës të të gjithë atyre që përdorin marijuanë, duke mbrojtur këtë kauzë. Sipas tij, është më mirë të miratohet përdorimi i saj pasi të gjithë e tymosin atë. Në një intervistë për CNBC, Durant sqaroi: "Nuk jam pionier i kësaj çështjeje apo i përdorimit të marijuanës. Thjesht më pëlqen si bimë. Ka! Çfarë i thashë Silverit për ta bindur? Kur u takuam e nuhati që kisha pirë dhe



nuk e mohova. I thashë që në NBA të gjithë e pinë, kjo është e vërteta. Është si të pish verë". Dikur, kur një lojtar kapej me marijuanë, herën e parë ishte i detyruar të niste një terapi për ta lënë atë. Herën e dytë gjobitej me 25 mijë

dollarë, ndërsa rasti i tretë ishte pezullim me 5 ndeshje. Në fakt, kontrollet ndaj marijuanës ishin zhdukur nga viti 2021. "Në botë dhe Amerikë gjërat kanë ndryshuar. Nuk ka efekt negativ për atë që e pi", ka thënë Duranti.

Al Hilali synon transferimin e Osimhenit dhe Verrattit



RIYADH, 27 KORRIK - Al Hilali nuk e ka ndërmend të dorëzohet pavarësisht refuzimit publik nga Kylian Mbappe. Sheikët kërkojnë një sulmues dhe tashmë kanë kthyer vështrimin nga Victor Osimhen. Sipas "L'Equipe", milionat që ishin destinuar për Mbappen do të shkojnë për ta siguruar kartonin e sulmuesit nigerian, sigurisht jo të gjitha, por një pjesë e mirë. Me shumë mundësi, përfaqësuesit e Al Hilalit

do të trokasin në derën e De Laurentis me 180 milionë euro, aq sa kërkon bos i Napolit për ta lënë të lirë sulmuesin më të mirë në Serinë A. Kur bëhet fjalë për kontrata personale, e sigurt është që klubet saudite nuk kanë rivalë. Fakt është që këtë periudhë Osimhen është kërkuar nga disa klube të rëndësishëm evropiane, ekipe si Bayern Munich apo Manchester Unitedi, por në çdo rast hasën në refuzimin e De Laurentis.

Fakt është gjithashtu që Napoli dhe Osimhen po negociojnë mundësinë për ta rinovuar kontratën aktuale deri më 2027. Sipas "L'Equipe", Al Hilali është shumë pranë arritjes së akordit me Marco Verrattin. Mesfushori i PSG-së është gati të firmosë një kontratë trevjeçare nga e cila do të përfitojë 25-30 milionë euro. Më herët, gjatë kësaj merkatoje vere, Al Hilali ka siguruar shërbimet e Milinković-Saviq dhe Koulibalyt.

SHKURT

Hendersoni zyrtarizohet tek Al-Ettifaqi

Al-Ettifaqi ka kompletuar transferimin e Jordan Hendersonit. Klubi saudit njoftoi zyrtarisht të enjten për marrëveshjen me mesfushorin anglez. Hendersoni me klubin nga Arabia Saudite ka nënshkruar kontratë trevjeçare. Al-Ettifaqi ka paguar 12 milionë funte për transferimin e 33-vjeçarit nga Liverpooli, pa përfshirjen e bonuseve. Hendersoni u largua nga "Të Kuqtë" pas 12 vjetëve. Ai iu bashkua Liverpoolit nga Sunderlandi në vitin 2011, fitoi shtatë trofe të mëdhenj gjatë kësaj periudhe, duke përfshirë Ligën e Kampionëve në vitin 2019 dhe u bë kapiteni i parë i "Të Kuqve" që ngrii trofeun e kampionit në Premierligë në historinë e klubit para tre vjetëve. Hendersoni bëri 492 paraqitje për Liverpoolin, shënoi 33 gola dhe kontribuoi me 61 asistime.

Ancelotti: Mbappe? Jemi të kompletuar

Real Madridi e fitoi miqësoren ndaj Manchester Unitedit (2-0), kurse pas ndeshjes trajneri Carlo Ancelotti është pyetur rreth transferimit të mundshëm të Kylian Mbappes. Tekniku italian ka thënë se skuadra e tij tashmë është e kompletuar. "Skuadra është shumë e mirë kështu. Jemi të kompletuar", ka thënë Ancelotti. Klubi spanjoll tashmë është forcuar që nga fillimi i kësaj merkato me ardhjet e Jude Bellingham, për 105 milionë euro, Brahim Diaz, Joselu dhe Arda Guler.

Sanchezi, afër rikthimit në Premierë Ligë

Sulmuesi 34-vjeçar kilian Alexis Sanchez është pranë rikthimit në Premierë Ligë sezonin e ardhshëm pas gati katër vjetësh. Për sulmuesin që sezonin e kaluar shkëlqeu në Ligën 1 me Marsejën (18 gola në 44 ndeshje) është interesuar skuadra e Nottingham Forestit. Ky do të ishte një transferim me koston zero për skuadrën e Nottinghamit, duke qenë se lojtari është për momentin pa kontratë. Në të shkuarën Sanchez ka luajtur me Arsenalin e Manchester Unitedin. Me "djajtë e kuq" ai nuk shkëlqeu shumë, por me "topçinjtë" ishte lider në fushë. Pas largimit nga Manchester Unitedi, lojtari ka luajtur me Interin dhe Marsejën. Në kampionatin francez ai u rikthye në nivelet e dikurshme, duke tërhequr vëmendjen e Nottinghamit, që kërkon një sulmues me përvojë dhe që e njej mirë kampionatin. Sanzhesi ka realizuar 63 gola në 154 ndeshje në Premierë Ligë.

Martinez: Lukaku më zhgënjeu, nuk ma hapi telefonin

Kapiteni i ri i Interit, Lautaro Martinez, ka bërë me dije se ka mbetur i zhgënjyer me sjelljen e Romelu Lukakut. Sulmuesi argjentinas ka konfirmuar se sulmuesi belg nuk ia ka hapur telefonin. "U zhgënjeva prej tij, mbeta keq, nuk e mohoj. Edhe unë u përpoqa ta telefonoja në ato ditë kaosi, por nuk m'u përgjigj kurrë. Kështu veptoi edhe me shokët e tjerë. Nuk iu përgjigj askujt... Pas gjithë këtyre viteve së bashku, unë u zhgënjeva prej tij. Por është zgjedhja e tij dhe i uroj fat", theksoi kampioni i botës me Argentinën, ka thënë Martinez.

Alonso: Ndihej mirë te Leverkuseni, të ardhmes nuk i dihet

Trajneri Carlo Ancelotti do të largohet nga Real Madridi në fund të sezonit 2023/24. Trajneri italian do ta marrë drejtimin e Brazilit, ndërsa "Los Blancos" qysh tani ka filluar të shikojë për

zëvendësuesin e tij. Xabi Alonso është kandidati kryesor për ta marrë drejtimin e Real Madridit nga sezoni i ri, derisa trajneri i ri spanjoll po bën shumë mirë në Gjermani me Bayer Leverkusenin.

Vetë trajneri spanjoll ka folur për interesimin e "Los Blancos", duke thënë se për momentin është i fokusuar vetëm te Bayer Leverkuseni. "Real? Të shohim... Tani për tani është më e rëndësishme

të mendoj për skuadrën. Ndihej mirë te Leverkuseni, si me ekipin ashtu edhe me drejtuesit. E ardhmja nuk është një çështje e rëndësishme për momentin", ka thënë Alonso.

41-vjeçari ka kaluar pesë vjet si futbollist i Real Madridit duke qenë një nga më të rëndësishmit në klubin madrilen. Ai për një edicion ka qenë trajner edhe i ekipit të rinjve të "Los Blancos".

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "VICIANAMED" SH.P.K. me seli në Vushtrri, pronar Sami Plakolli dhe Fitim Krasniqi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811409631 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "VICIANAMED" D.O.O. Vushtrri, sa vllasnikom Sami Plakolli, Fitim Krasniqi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811409631 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "VICIANAMED" L.L.C. with headquarters Vushtrri, with owner Sami Plakolli and Fitim Krasniqi, has come to the decision to quit its business: 811409631 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albert Dina shpall të pavlefshme dëftesat e kl I – IX - SHFMU "Faik Konica" Celinë.

- Besmir Hasani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI –IX- SHFMU "Mati Logoreci" Prizren.

- Durim Lubiceva shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



Në bazë të dispozitave të nenit 21, nenit 25 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, respektivisht nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Komisioni i Auditimit i Ndërmarrjes Publike KRM "Pastrimi" Sh.A – Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2023, mori vendim që të shpallë, ndërsa pasi që në afatin e shpallur prej 15 dite nuk kishte asnjë aplikacioni, Komisioni i Auditimit në mbledhjen e mbajtur me datë 24.07.2023, merr vendim për rishpallje të konkursit:

KONKURS

Pozita e punës: Auditor/e Brendshëm 1 ekzekutues

Vendi dhe lokacioni i Punës: Prishtinë

Auditori/e e Brendshëm/ Nën mbikëqyrje të Komitetit të Auditimit

Kohëzgjatja e Kontratës së punës tri (3) vjeçare

Detyrat dhe përgjegjësitë: - Nën mbikëqyrjen e zyrarit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm kryen punët dhe detyrat si në vijim:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve përkatëse;
- Kryen auditime, përfshirë intervista hyrëse me sektorin që auditohet, interviston stafin, merr dhe analizon dokumentacionin përkatës dhe regjistron të gjeturat;
- Përgatitë draft raportin, diskuton me mbikëqyrësin dhe bën intervistën përfundimtare me të audituarin;
- Harton raportin final, me rekomandimet adekuate, finalizon dosjen e auditimit, dhe dorëzon atë për arkivim;
- Monitoron zbatimin e rekomandimeve nga ana e njësisë organizative;
- Ofron këshilla dhe udhëzime për çështje të auditimit të brendshëm brenda kompanisë sipas nevojës;
- Koordinon punët me pjesët e tjera të njësisë dhe komunikon me autoritetet e jashtme sipas nevojës;
- Të vlerësojë sistemet e kontrollit të brendshëm të dizajnuara nga menaxhmenti se janë adekuate.

Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo fusha tjera të studimeve relavante, master në drejtimet ekonomike me theks në kontabilitet dhe auditim do të jetë përparësi.
- Së paku 3 vite përvojë pune në auditimit të brendshëm, kontabilitet dhe lëminë e financave.
- Njohuri dhe përvojë në fushën e auditimeve (përvojë pune në auditimin e ndërmarrjeve publike dhe private do të jetë përparësi)
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme me theks Ligji për NP dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave publike;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit, përparësi kanë ata me përvojë menaxheriale në ndërmarrjet publike dhe private.
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Të jetë i certifikuar në auditim të brendshëm në sektorin publik, lëshuar nga Ministria e Financave ose Çertifikat për auditor të brendshëm në sektorin publik dhe privat nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtarë ose vendor.
- Të jetë ekspert në kontabilitet (Kontabilist i Çertifikuar) nga SKAK, IKAF apo ndonjë institucion tjetër vendor apo ndërkombëtarë.
- **Kualifikimet e preferuara**
- Trajnime (EVP) relavante në auditim të brendshëm që dëshmojnë me çertifikata
- Njohuri të programeve të ndërmarrjeve publike

Paraqitja e kërkesave

- 1.Kërkesat dorëzohen në zyrën nr. 8 të KRM "Pastrimi" Sh.A, Rr.Tahir Zajmi, nr.5, Prishtinë dhe duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:
- 2.CV, Përvoja e punës e dëshmuar me kontrata të punës dhe vendime (të noterizuar, Vërtetim nga trusti pensional), Diplomën e fakultetit (e noterizuar), Diploma nga universitetet e huaja duhet të jetë e noterizuar nga Ministria e Arsimit (dëshmi e noterizuar), Çertifikata e auditimit të brendshëm, Çertifikata e kontabilistit (e noterizuar), Çertifikata e lindjes jo më e vjetër se 6 muaj, Kopja e letërnjoftimit, Gjendjen e pagesës nga Trusti, Dëshminë se nuk jeni nën hetime çertifikata origjinale jo më e vjetër se 6 muaj.
3. Deklarata nën betim (merret në ndërmarrje).
- 4.Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.
- 5.Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
- 6.Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
- 7.Informata shtesë mund të sigurohen përmes telefonit nr.038/603-191.

Kryesusi i Komisionit Auditimit
Valon Gogiqi



Na osnovu odredaba člana 21, člana 25 Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, odnosno član 13 Zakona br. 04/L-111 za izmene i dopune Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, kao i član 22 Zakona br. 06/L-021 za unutrašnju kontrolu javnih finansija, Komisija za reviziju Javnog preduzeća KRM „Pastrimi“ Sh.A – Priština, na sednici održanoj 29.06.2023.godine, odlučila je da saopšti, dok je od isteka roka oglašenog za 15. dana, nije bilo prijave, Komisija za reviziju na sednici održanoj 24.07.2023. godine donosi odluku o ponovnom raspisivanju konkursa:

KONKURS

Radno mesto: Interni Revizor 1 izvršilac

Mesto i lokacija rada: Priština

Interni revizor/ Pod nadzorom Komisije za reviziju

Trajanje ugovora o radu je tri (3) godine

Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom službenika Jedinice za unutrašnju reviziju obavlja sledeće poslove i poslove:

- U saradnji sa supervizorom učestvuje u izradi plana revizije i odobrava planove rada i rokove za obavljanje revizija i pratećih usluga;
- Vršiti revizije, uključujući uvodne intervjuje sa revidiranim sektorom, intervjuje osoblje, prima i analizira relevantnu dokumentaciju i evidentira nalaze;
- Priprema nacrt izvještaja, razgovara sa supervizorom i obavlja završni intervju sa subjektom revizije;
- Izrađuje završni izveštaj, sa adekvatnim preporukama, finalizuje dosije revizije i dostavlja ga na arhiviranje;
- Prati sprovođenje preporuka po organizacionim jedinicama;
- Pruža savete i smernice o pitanjima interne revizije unutar kompanije po potrebi;
- Koordinira rad sa drugim delovima jedinica i po potrebi komunicira sa spoljnim organima;
- Da proceni sisteme unutrašnje kontrole koje je dizajnirao menadžment da su oni adekvatni.

Kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:

- Visoka diploma ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija, računovodstva ili drugih relevantnih smerova studija, magistar ekonomije sa akcentom na računovodstvo i reviziju biće prednost.
- Najmanje 3 godine radnog iskustva u oblasti interne revizije, računovodstva i finansija.
- Znanje i iskustvo u oblasti revizije (radno iskustvo u reviziji javnih i privatnih preduzeća će biti prednost)
- Poznavanje važećih zakona i propisa, sa akcentom na Zakon o privatnim preduzećima i druge zakone koji se odnose na internu kontrolu i upravljanje javnim finansijama;
- Veštine u komunikaciji, planiranju rada i vođenju tima, prednost imaju oni sa menadžerskim iskustvom u javnim i privatnim preduzećima.
- Poznavanje rada na računaru u softverskim aplikacijama (Vord, Ekcel, Pover Point, Access);
- Da bude sertifikovan za internu reviziju u javnom sektoru, izdat od strane Ministarstva finansija ili Sertifikat za internog revizora u javnom i privatnom sektoru od bilo koje relevantne međunarodne ili domaće institucije.
- Budite stručnjak za računovodstvo (Sertifikovani računovođa) iz SKAK-a, IKAF-a ili bilo koje druge lokalne ili međunarodne institucije.

Poželjne kvalifikacije:

- Relevantne obuke (EVP) iz interne revizije koje dokazuju sertifikatima
- Poznavanje programa javnih preduzeća

Podnošenje zahteva:

1. Zahtevi se predaju u kancelariju br. 8 KRM "Pastrimi" Sh.A, ul.Tahir Zajmi, br.5, Priština i potrebno je priložiti sledeća dokumenta:
2. CV, Radno iskustvo dokazano ugovorima o radu i odlukama (ovjereno, Uvjerenje iz penzijskog fonda), Fakultetska diploma (ovjerena), Diploma inostranih univerziteta mora biti ovjerena od strane Ministarstva prosvjete (dokaz kod notara), uvjerenje interne revizije, uvjerenje računovođe (overen kod notara), izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od 6 meseci, kopija lične karte, izvod o uplati fonda, dokaz da niste pod istragom original izvod ne stariji od 6 meseci.
3. Izjava pod zakletvom (primljena u kompaniji).
4. Nepotpuna dokumenta, kao i ona koja pristignu nakon konkursnog roka, neće se razmatrati.
5. Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.
6. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi.
7. Dodatne informacije mogu se dobiti na telefon 038/603-191.

Šef Komisije za Reviziju

Valon Gogiqi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

